



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/134

Datë: 14.07.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që planin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 02/134

Datë: 14.07.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Mbrojtjen e Natyrës.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

proe. Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/134

Datë: 14.07.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2010, mori

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtar të Bordit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit i propozon Kuvendit të Kosovës këta kandidatë:
 - Z. Dino Asanaj;
 - Z. Slobodan Petrovic;
 - Z. Haxhi Arifi;
 - Z. Bahri Shabani.
2. Z. Naser Osmani, i propozuar për anëtar të Bordit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me vendimin Qeverisë Nr.03/117, i datës 30 mars 2010 konsiderohet i zgjedhur.
3. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që emrat e të propozuarve nga pika 1. e këtij vendimi, së bashku me biografite, t'ia procedojë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/134
Datë: 14.07.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2010, mori

V E N D I M

1. Akreditohet Universiteti i Prishtinës në nivel institucional.
2. Akreditohen këto programe të studimit në Fakultetin Ekonomik: Ekonomiks (BSc dhe MSc); Banka, Financa dhe Kontabilitet (BSc dhe MSc); Menaxhment dhe Informatikë (BSc dhe MSc); Marketing (BSc dhe MSc); Kontabilitet (BA).
3. Akreditohen këto programe të studimit në Fakultetin e Shkencave Aplikative të Biznesit në Pejë: Administrim Biznesi (BSc); Informatika e Aplikuar në Biznes (BSc); Kontabilitet dhe Financa na Biznes në gjuhën shqipe dhe boshnjake (BSc).
4. Akreditohen këto programe të studimit në Fakultetin Filozofik: Filozofi (BSc); Histori (BSc); Histori e Kohës së Re (MSc); Pedagogji Sociale (BSc dhe MSc-me rekomandim që të zhvillohet në kuadër të tri departamenteve: Sociologji, Pedagogji dhe Psikologji); Sociologji (BSc); Sociologji Pedagogjike (MSc); Sociologji e Përgjithshme (MSc); Shoqëria Civile dhe Zhvillimi Lokal (MSc); Pedagogji e Përgjithshme (BSc-me rekomandim që të zhvillohet në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës); Menaxhimi në Edukim (MSc-me rekomandim që të zhvillohet në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës); Shkencat Politike (BSc-pasi që i kanë përmbushur rekomandimet e ekspertëve nga viti 2009); Psikologji (BSc-akreditim për një vit pasi që janë përmbushë rekomandimet e ekspertëve nga viti 2009); Etnologji dhe Antropologji Kulturore (BA-akreditim për një vit me kusht).
5. Nuk akreditohet ky program studimi: Historia e mesjetës e Ballkanit (MA).

6. Akreditohen këto programe të studimit në Fakultetin e Mjekësisë: Mjekësi e Përgjithshme (akreditim për dy vite pasi që janë përmbushur rekomandimet e ekspertëve nga viti 2009); Farmaci (akreditim për një vit pasi që janë përmbushur rekomandimet e ekspertëve nga viti 2009); Stomatologji; Fizioterapi (BA); Infermieri dhe Mami (BA); Menaxhment në Shëndetësi (MA).
7. Nuk akreditohet ky program studimi: Fizioterapi (në nivelin Master).
8. Akreditohen këto programe të studimit në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës: Konstruktiv (BA dhe MA); Hidroteknikë (BA dhe MA); Gjeodezi (BA); Arkitekturë (BA dhe MA).
9. Akreditohen këto programe të studimit në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike: Prodhim dhe Automatizim (BEng dhe MEng); Termoteknologji dhe Termoenergjetikë (BEng dhe MEng); Ndërtim dhe projektim (BEng dhe MEng); Trafik dhe Transport (Beng-akreditim për një vit me kusht); Mekatronikë (MEng).
10. Nuk akreditohet ky program studimi: Trafik dhe Transport (M Eng).
11. Akreditohen këto programe të studimit në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë: Agroekonomi (BA); Prodhimtari blegtoriale (BA dhe MA); Lavërtari-Perimtari (BA dhe MA); Pemëtari - Vreshtari (BA dhe MA); Mbrojtja e Bimëve (BA - akreditim për një vit me kusht). Akreditohet edhe programi i studimit Mjekësi Veterinare (studime pesëvjeçare-akreditim për dy vjet me kusht).
12. Nuk akreditohen këto programe të studimit: Agroekonomi (MSc); Mbrojtja e bimëve (MSc).
13. Akreditohen këto programe të studimit në Fakultetin e Shkencave Teknike të aplikuara në Mitrovicë: Makineri industriale (BA); Informatikë Inxhinierike (BA); Teknologji e përpunimit me prerje (MA).
14. Akreditohen këto programe të studimit në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit: Kulturë fizike dhe Sport (BSc-program 4 vjeçar).
15. Akreditohen këto programe të studimit në Fakultetin Juridik: Drejtësi (LLB dhe LLM-akreditim për periudhë dy vjeçare programi me kusht); E drejta civile dhe e pronës (LLM); E drejta ndërkombëtare (LLM).
16. Akreditohen këto programe të studimit në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore: Matematikë e Përgjithshme (BSc dhe MSc); Matematika Arsimore (BA Ed); Shkenca kompjuterike (BSc); Fizika Arsimore (BA Ed); Fizikë Inxhinierike(BSc); Fizika e Përgjithshme (MSc); Kimia Arsimore (Ba Ed.); Kimi (Ma Ed); Kimi Inxhinierike (BSc); Kimia Organike dhe Biokimia (MSc); Kimia Fizike dhe Inorganike (MSc); Kimia Analitike dhe Ambientale (MSc); Biologji Arsimore (Ba Ed.); Biologji (Ma Ed.); Ekologji dhe Mbrojtje e Ambientit (BSc dhe MSc); Biokimi-Fiziologji (MSc); Gjeografi arsimore(Ba Ed); Gjeografi Aplikative

(BA); Modelet Hapësinore Socio-Ekonomike (MSc); Resurset Natyrore dhe Ambienti (MSc); Popullsia (MSc).

17. Akreditohen këto programe të studimit në Fakultetin e Edukimit; Programi parashkollor (BA); Programi i arsimit fillor (BA); Programi i arsimit të qëndrueshëm parashkollor dhe edukimit paqësor Dielli (BA); Mësimdhënia dhe Kurrikuli (MEd dhe MA); Udhëheqja në Arsim (MEd dhe MA).
18. Programet e studimit: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe (BA); Gjuhë dhe Letërsi Angleze (BA); Fizikë-Kimi (BA); Biologji-Kimi (BA); Matematikë-Informatikë (BA); Teknologji informative (BA); Histori-Edukatë qytetare (BA); Gjeografi-Edukatë qytetare (BA) akreditohen për një vit me kusht që pas një viti të transferohen në fakultetet përkatëse të Universitetit të Prishtinës dhe me rekomandim që degët e Fakultetit të Edukimit të transferohen në Prishtinë dhe të mos pranojnë studentë në vitin akademik 2010/2011.
19. Akreditohen këto programe të studimit në Fakultetin Filologjik; Gjuhë Shqipe (BA dhe MA); Letërsi Shqipe (BA dhe MA); Gjuhë dhe Letërsi Angleze (BA dhe MA); Gjuhë dhe Letërsi Frënge (BA dhe MA); Gjuhë dhe Letërsi Turke (BA); Orientalistikë (BA); Gazetari (BA dhe MA me kusht); Gjuhë dhe Letërsi Gjermane (BA-akreditohet për një vit më kusht).
20. Nuk akreditohen këto programe të studimit: Letërsia e Përgjithshme dhe Krahasimtare (BA dhe MA); Gjuhë dhe Letërsi Turke (MA); Gjuhë dhe Letërsi Gjermane (MA).
21. Akreditohen këto programe të studimit në Fakultetin e Shkencave Teknike Aplikative në Ferizaj: Industria e drurit (BA-akreditim për një vit më kusht); Makineri (BA- akreditim për një vit më kusht).
22. Nuk akreditohet ky program studimi: Industria e Drurit (MA).
23. Akreditohen (akreditim me kusht për dy vjet) këto programe të studimit në Fakultetin e Arteve: Pikturë (BA dhe MA); Skulpturë (BA dhe MA); Grafikë (BA dhe MA); Dizajn Grafik (BA); Skenografi (BA dhe MA); Grafikë (MA); Dizajn Grafik (MA - me programet: Përgatitja e Librit; Shkrimi Tipografik; Grafikë Reklamuese; Multimedia; Fotografi); Dirigjim (BA); Komponim(BA); Pedagogji e përgjithshme muzikore (BA); Piano dhe Perkusione (BA); Harkore dhe Kitara (BA); Frymore (BA); Solo Këndim (BA); Muzikologji (BA); Etnomuzikologji (BA); Moduli Artistik (MA-me programet: Interpretimi, Kompozimi, Dirigjimi); Moduli Teorik -Shkencor (MA-me programet: Teorikë, Muzikologji); Moduli Pedagogjik (MA - me programet: Pedagogji e përgjithshme e muzikës; Pedagogji instrumentale; Pedagogji e shkollimit muzikor profesional); Aktrimi (BA dhe MA); Regji Teatri (BA dhe MA); Dramaturgji (BA dhe MA); Regji Filmi (BA dhe MA).
24. Fakulteti Xehetaro Metalurgjik dhe Fakulteti i Inxhenierisë Elektrike janë në proces të akreditimit.

25. Akreditimi zgjatë 3 vite, përveç në rastet kur precizohet ndryshe.
26. Në programet e pa akredituara nuk mund të pranohen studentë të rinj.
27. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Agjencioni Kosovar për Akreditim (AKA) dhe Universiteti i Prishtinës (UP).
28. Për monitorimin e përmbushjes së rekomandimeve në rastet e akreditimit me kusht obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Agjencioni Kosovar për Akreditim.
29. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/134

Datë: 14.07.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2010, mori

V E N D I M


1. Ri akreditohet si "Kolegj", BPrAL "AAB-Riinvest" me këto programe të studimit: Gazetari (BSc); Komunikim Masiv-Produksioni (BSc); Komunikim Masiv dhe Gazetari (MSc); Juridik (LLB); Juridik-Civil (LLM); Administratë Publike (LLB, akreditim me kusht për një vit); Kujdesi dhe mirëqenia e fëmijëve (BA-akreditim me kusht për një vit); Gjuhë Angleze-Përkthimi (BA-akreditim me kusht për një vit); Ekonomia e Biznesit (BA); Banka, Financa dhe Kontabilitet (BA); Menaxhment dhe Informatikë (BA dhe MA); Marketing dhe Administrim Biznesi (BA); Financa Zhvillimore (MA); Tregjet Financiare dhe Bankat (MA); Shkenca Kompjuterike, Inxhiniering Softueri (BSc); Ekonomi dhe Financa (MA); Kulturë Fizike dhe Sporte (BA dhe MA).
2. Nuk akreditohen këto programe studimi: Telekomunikim (BSc); Kriminalistikë (BSc); Juridik-Penal (MSc); Sociologji dhe Ndryshime Sociale (BSc).
3. Ri akreditohet si "Kolegj", BPrAL "FAMA" me këto programe të studimit: Bankat, Financat dhe Kontabiliteti (BA dhe MA); Menaxhmenti (BA dhe MA); Juridik i përgjithshëm (LLB); Kriminalistikë (LLB); Shkenca Politike dhe Administrim Publik (BA); Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci (MA); Shkenca e Sigurisë (MA); Psikologji (BA-akreditim për një vit, me kusht); Shkenca Sociale-Sociologji (BA-akreditim për një vit me kusht); Administratë Publike (MA); Juridiko-Penal (LLM-akreditim për një vit); Juridiko-Civil (LLM-akreditim për një vit).
4. Nuk akreditohen këto programe studimi: Komunikim (BA); Informatikë e Aplikuar (BSc); Menaxhment i Turizmit dhe Hotelierisë (BA).
5. Ri akreditohet si "Kolegj", BPrAL "ILIRIA" me këto programe të studimit: Shkenca Kompjuterike dhe TI e Aplikuar (BA në Prishtinë dhe Pejë);

- Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci (BA në Prishtinë-akreditim me kusht për një vit); Kulturë Fizike dhe Sport (BA), Kulturë Fizike dhe Sport (MA - akreditim për një vit, me kusht); Banka, Financa dhe Kontabilitet (BA në Prishtinë dhe Pejë dhe MA në Prishtinë); Menaxhment dhe Informatikë (BA në Prishtinë dhe Pejë, MA në Prishtinë); Biznes Ndërkombëtar (BA në Prishtinë-akreditim për një vit); Juridik (LLB në Prishtinë); Juridik-Civil (LLM në Prishtinë).
6. Nuk akreditohen këto programe studimi: Shkencat Kompjuterike dhe TI e Aplikuar (MA); Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci (MA); Biznes Ndërkombëtar (MA); Juridik Penal (BSc); Stomatologji (Dr. i Stomatologjisë); Infermieri (BA); Mjekësi Sanitare (BA); Radiologji Diagnostike (BA).
 7. Ri akreditohet si "Kolegj", BPrAL "UBT" me këto programe të studimit: Sistemet Informative (BSc-akreditim për një vit); Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri (BSc dhe MSc); Menaxhim i Mekatronikës (BSc dhe MSc); Menaxhmenti, Biznesi dhe Ekonomia (BA me dy specializime), Menaxhmenti, Biznesi dhe Ekonomia (MA me dy specializime-akreditim për një vit); Juridik (LLB 8 Semestra/240 ECTS- akreditim për një vit, me kusht).
 8. Nuk akreditohen këto programe studimi: Sistemet Informative (MSc); Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane (BA); Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci (MA); Komunikim, Gazetari dhe Multimedia (BA); Ekonomi dhe Menaxhim i Resurseve (BSc); Menaxhimi i Biznesit (MBA); Ndërtimtari dhe Infrastrukturë (BSc dhe MSc); Arkitekturë (BA dhe MSc); Urbanizmi dhe Planifikimi Hapësinor (MSc); Dizajn i Brendshëm Arkitektural (BA).
 9. Ri akreditohet si "Kolegj", BPrAL "DARDANIA" me këto programe të studimit: Banka, Financa dhe Kontabilitet (BA dhe MA); Administratë Publike (BA dhe MA); Administrim Biznesi (BA dhe MA); Drejtësi e Përgjithshme (LLB); Gjuhë Angleze dhe Studime Amerikane (BA-akreditim për një vit); Psikologji aplikative dhe studime menaxhariale (BA- akreditim për një vit).
 10. Nuk akreditohen këto programe studimi: Menaxhment (BA dhe MA); Psikologji e Aplikuar-Zhvillimi dhe Socializimi i Fëmijëve (BA).
 11. Ri akreditohet si "Kolegj", BPrAL "VICTORY" me këto programe të studimit: Ekonomia e Biznesit-Tregti Ndërkombëtare (BA); Politika Ndërkombëtare dhe Diplomacia (BA); Politikat ndërkombëtare dhe diplomacia (MA-akreditim për një vit, me kusht); Programi Juridik-Marrëdhënie ndërkombëtare (LLB-akreditim për një vit, me kusht).
 12. Nuk akreditohen këto programe studimi: Menaxhim Biznesi në Tregtinë e jashtme dhe të brendshme (MSc); Juridik-E drejta ndërkombëtare publike dhe private (MSc (2 semestra/4 semestra); Juridik-Marrëdhëniet ndërkombëtare legale (BSc Jurist i diplomuar-studime 4 vjeçare).

13. Ri akreditohet si "Kolegj", BPrAL "Kolegji për Studime të Menaxhmentit Ndërkombëtar (KSMN)" me këto programe të studimit: Menaxhment i Përgjithshëm Ndërkombëtar (BA dhe MA) dhe Financat dhe Kontabiliteti Ndërkombëtar (BA dhe MA).
14. Ri akreditohet si "Kolegj", BPrAL "UNIVERSUM" me këto programe të studimit: Biznes dhe Menaxhment (BA); Administratë Publike, Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane (BA-akreditim për një vit); Menaxhment (MA - akreditim për një vit, me kusht).
15. Nuk akreditohen këto programe studimi: Menaxhim i Sistemeve Informative (BA); Menaxhim i sporteve (BA).
16. Ri akreditohet si "Kolegj", BPrAL "BIZNESI" me këto programe të studimit: Banka dhe Financa në Biznes (BA); Menaxhim i Emergjencave (Diplomë profesionale e nivelit të 6 sipas KEK (Korniza Evropiane e Kualifikimeve); Menaxhim i Emergjencave (Diplomë profesionale e nivelit të 7 sipas KEK-akreditim për një vit); Juridik (BA-akreditim për një vit); Menaxhmenti dhe Ekonomia (BA-akreditim për një vit); Menaxhment dhe Financa (MA-akreditim për një vit).
17. Nuk akreditohet ky program studimi: Juridik i përgjithshëm (MA).
18. Ri akreditohet si "Kolegj", BPrAL "Kolegji për Studime të Shkencave të Aplikuara Organizative "Pjetër Budi" me këto programe të studimit: Dogana dhe Shpëdicion (BA); Dogana dhe Shpëdicion (MA-akreditim me kusht për një vit); Sigurime (BA); Menaxhim i Turizmit dhe Hotelarisë (BA); Administrim Biznesi (BA me dy specializime-akreditim me kusht për një vit).
19. Nuk akreditohen këto programe studimi: Menaxhimi i Resurseve Njerëzore (BA dhe MA); Menaxhim i Turizmit dhe Hotelarisë (MA).
20. Ri akreditohet si "Shkollë e Lartë Profesionale" e Artit, BPrAL "Evolucion" me këto programe të studimit: Dizajni i Modës (Diplomë Profesionale në nivel 6, 5 të KEK); Dizajn Enterier (Diplomë Profesionale në nivel 6 të KEK); Dizajn Komunikimi (Diplomë Profesionale në nivel 6 të KEK); Arte mediale (Diplomë Profesionale në nivel 6 të KEK); Arti Bashkëkohor (Diplomë Profesionale në nivel 6 të KEK - akreditim për një vit).
21. Nuk akreditohen këto programe studimi: Dizajn Enterier (Program profesional një vjeçar); Dizajn Urban (MA).
22. Ri akreditohet si "Shkollë e Lartë Profesionale", BPrAL "TEMPULLI" me këto programe të studimit: Komunikacioni Rrugor dhe Transporti (Diplomë Profesionale në nivel 6, 5, 4 të KEK); Trafiku Hekurudhor dhe Transporti (Diplomë Profesionale në nivel 6, 5, 4 të KEK); Komunikacionin Postar dhe Telekomunikacioni (Diplomë Profesionale, në nivel 6, 5, 4 të KEK); Trafiku ajror dhe Transporti (Diplomë Profesionale në nivel 5, 4 të KEK , akreditim për një vit).

23. Nuk akreditohen këto programe studimi: Trafiku Ajror dhe Transporti (Diplomë Profesionit në nivel 6 të KEK); Logjistika dhe Transporti-(Diplomë Profesionit në nivel 6, 5, 4 të KEK).
24. Ri akreditohet si "Shkollë e Lartë Teknike", BPrAL "Design Factory" me këtë program studimi: Modelizëm dhe Stilizëm (Certifikatë në nivel 5 të KEK).
25. Akreditohet (me kusht) si "Institut", BPrAL "Gjilani" me këto programe të studimit: Juridik i Përgjithshëm (LLB-akreditim për një vit); Banka, Financa, Kontabilitet (BA-akreditim për një vit); Menaxhment (BA-akreditim për një vit).
26. Akreditohet si "Institut", BPrAL "Shkolla Evropiane për Drejtësi dhe Qeverisje" me këto programe studimi: Drejtësi (LLB-akreditim për një vit); Drejtësi dhe Menaxhim i Patundshmërisë dhe Infrastrukturës (LLB -akreditim për një vit).
27. Nuk akreditohen këto programe studimi: Drejtësi (LLM); Drejtësi dhe Menaxhim i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (LLM); Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci (MA).
28. Akreditohet (me kusht) si "Institut", BPrAL "Instituti për Studime Politike dhe Evropiane" (ISPE) me këtë program të studimit: Studime të Integruara Evropiane (BA-akreditim për një vit).
29. Akreditohet (me kusht) si "Shkollë e Lartë Profesionale", BPrAL "BIOMEDIKA" me këto programe të studimit: Infermieri (Diplomë profesionale në nivel 6 të KEK-akreditim për një vit); Fizioterapi (Diplomë profesionale në nivel 6 të KEK-akreditim për një vit); Laborator Medicinal (Certifikatë në nivel 5 të KEK, për një vit).
30. Nuk akreditohet ky program studimi: Inxhinieri Sanitare (BSc).
31. Akreditohet (me kusht) si "Shkollë e Lartë Profesionale", BPrAL "QEAP-HEIMERER" dhe programi i studimit: Pedagogji Profesionale në Shëndetësi (Diplomë profesionale në nivel 6 të KEK - akreditim për një vit).
32. Nuk akreditohet BPrAL "UNIPZ" në Prizren dhe as programet e studimit: Banka, Financa dhe Kontabilitet (BA); Menaxhment(BA); Juridik i përgjithshëm (LLB); Banka, Financa dhe Kontabilitet (MA); Juridik-Penal (LLM).
33. Nuk akreditohet BPrAL "Instituti ADesign" dhe as programet e studimit: Arkitekturë (MA); Enterier (BA); Komunikim Vizual(BA); Pikturë(BA).
34. Nuk akreditohet BPrAL Shkolla e Lartë Profesionale e Farmacisë "Profesional" dhe as programi i studimit: Farmaci (Diplomë në nivel 6 të KEK). Ky vendim është marrë në mbledhjen e 13-të të Këshillit Kombëtar të Cilësisë, më 28 Janar 2010).

35. Asnjë Bartës Privat i Arsimit të Lartë (BPrAL) në Republikën e Kosovës, aktualisht nuk mund të bartë emrin Universitet, të jep tituj akademikë për mësimdhënësit apo të ofrojë studime të Doktoratës.
36. Akreditimi zgjatë 3 vite, përveç në rastet kur precizohet ndryshe.
37. Në programet e paakredituara nuk mund të pranohen studentë të rinj.
38. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që në përputhje me këtë vendim të përgatisë dhe lëshojë licencat.
39. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë Agjencia Kosovare e Akreditimit që të monitorojnë përmbushjen e rekomandimeve në rastet e akreditimit me kusht.
40. Kundër këtij vendimi lejohet ankesa në afatin e paraparë ligjor, para organit kompetent.
41. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/134
Datë: 14.07.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2010, mori

V E N D I M

1. Universiteti i Prizrenit, mund të shpallë konkurs për pranimin e studentëve ne vitin akademik 2010/2011 përderisa vazhdon procedura e akreditimit sipas agjendës së paraparë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë